



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 25/11/2025

Ora e hapjes së mbledhjes 11:00

Marrin pjesë:

1. znj.Edlira Mitre
2. znj.Ornela Alikaj
3. znj.Jorida Romaçka
4. znj.Laureta Alidinaj

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Evis Naci Sek. e Këshilli

Nga ekzekutivi marrin pjesë: Alfons Vranishti, Mirela Balli, Kristi Mitaçe

Kryesuesi i mbledhjes është znj. Edlira Mitre.

Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka raste konflikti interesi

Pikat e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim (pika 3 e rendit të ditës)** 3- “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 TETOR 2025” *propozuar nga ekzekutivi.*
2. **Projekt-vendim (pika 4 e rendit të ditës)** 4- “MBI PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË HARTIMIN E PROJEKT RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE MASAT NË RASTET E MOSBANIMIT OSE MOS SHFRYTËZIMIT PËR BANIM” *propozuar nga ekzekutivi.*
3. **Projekt-vendim (pika 5 e rendit të ditës)** 5- “MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.57 DATË 26.06.2025, “MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMIJET E PASTREHA” *propozuar nga ekzekutivi.*
4. **Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës)** 6- “MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” *propozuar nga ekzekutivi.*

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet.

U sqaruan nga përfaqësuesit e administratës nevojat për projekt vendimet. U sqarua situata e trajtimit të rastit me apartament, kriteret dhe kushtet.

Nuk pati pyetje.

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga kryetari

U votua Projekt vendimi sipas pikës 1: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.

U votua Projekt vendimi sipas pikës 2: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.

U votua Projekt vendimi sipas pikës 3: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.

U votua Projekt vendimi sipas pikës 4: PRO 4, KUNDER 0, ABSTENIM 0. Miratohet.

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes 11 :20.

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari/NënKryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.____ datë 25/11/2025

Nr.____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues, në lidhje me propozimet:

1. **Projekt-vendim (pika 3 e rendit të ditës)** 3- “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 TETOR 2025” *propozuar nga ekzekutivi.*
2. **Projekt-vendim (pika 4 e rendit të ditës)** 4- “MBI PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË HARTIMIN E PROJEKT RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE MASAT NË RASTET E MOSBANIMIT OSE MOS SHFRYTËZIMIT PËR BANIM” *propozuar nga ekzekutivi.*
3. **Projekt-vendim (pika 5 e rendit të ditës)** 5- “MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.57 DATË 26.06.2025, “MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMIJET E PASTREHA” *propozuar nga ekzekutivi.*
4. **Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës)** 6- “MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” *propozuar nga ekzekutivi.*

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

Ligjin nr.139, date 17.12.2015, "Per veteqeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar, ne mbeshtetje te nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nenpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025". VKB Nr.176, date 26.12.2024, "Mbi Miratimin e Buxhetit vjetor te vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 te Bashkise Korce", udhezimin plotesues Nr.2, date 24.01.2025, per zbatimin e buxhetit te vitit 2025. Ligjit nr.57/2019 " Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise", ne mbeshtetje te neneve 78 dhe 83, pika 1, te Kushtetutes, me propozim te Keshillit te Ministrave, te V.K.M Nr.597, date 04.09 .2019, "Per percaktimin e kriterave, te procedurave, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te Ndihtmes Ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike"i ndryshuar, ne mbeshtetje te nenit 100 te kushtetutes, te neneve 12, pikat 1,4,5, 16, pika 2 dhe 21 te ligj it nr 57/2019 "Per asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise", te Udhezimeve m. 3, 4, 5, pika 2, date 17.02.2017 te Ministrit te Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, date 30.01.2025 te Keshillit Bashkiak Korçe, "Per miratimin e kriterave per familjet ne nevojte qe dote trajtohen me ndihme ekonomike, deri ne 6% te fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor te Bashkise, i ndryshuar, Ligjit 22/1018 “Per Strehimin Social”, VKM 384 dt 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit qe duhet te paraqese familja per tu strehuar sipas njerit prej programeve sociale te strehimit dhe te afateve, procedurave te miratimit nga organet e qeverisjes vendore" etj

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevojë për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Projekt vendimet janë periodike në bazë të procedurave dhe dokumentacionet që plotësojnë banorët.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar apo nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Fondi prej 6% është i parashikuar prej fillimit të vitit dhe është pjesë e buxhetit të Bashkisë.

Pika 2 nuk ka efekte financiare.

Pikat 3 dhe 4 kanë të miratuar dhe përfshirë shpenzimet e tyre në buxhet.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Finances, Buxhetit.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Finances, Buxhetit. Raportimi në raportin e buxhetit 2025

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Përfitojnë familjet në vështirësi ekonomike të cilat për shkaqe të ndryshme nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit. Procedurë ligjore e përmujashme.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015 ?)

Jo

Komisioni i Përhershëm për **Mirëqenien Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore**, i mbledhur me datën 25/11/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

5. **Projekt-vendim (pika 3 e rendit të ditës)** 3- “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 TETOR 2025” *propozuar nga ekzekutivi.*
6. **Projekt-vendim (pika 4 e rendit të ditës)** 4- “MBI PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË HARTIMIN E PROJEKT RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE MASAT NË RASTET E MOSBANIMIT OSE MOS SHFRYTËZIMIT PËR BANIM” *propozuar nga ekzekutivi.*
7. **Projekt-vendim (pika 5 e rendit të ditës)** 5- “MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.57 DATË 26.06.2025, “MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMIJET E PASTREHA” *propozuar nga ekzekutivi.*
8. **Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës)** 6- “MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” *propozuar nga ekzekutivi.*

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 25/11/2025